Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-324
Datë 31.05.2019

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 21.05.2019 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Rivalidohet dhe riakreditohet "Cacttus Education" Sh.P.K, me adresë, rruga "Bashkim Fehmiu", Arbëria 3, BC2/11 nr.4 në Prishtinë, për periudhën pesë vjeçare 21. 05. 2019 deri 21.05.2024 me kualifikimet:

   1.1. **Administrator i rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, Niveli V sipas KKK me 240 kredi të AAP**

   1.2. **Zhvillues i web-it dhe i aplikacioneve mobile, Niveli V sipas KKK me 240 kredi të AAP**

2. Numri i kandidatëve që lejohet për grup duke u bazuar në hapësirën fizike, në pajisjet dhe mjetet e punës për ushtrimin praktik për kualifikimet:
   - Administrator i rrjetave dhe sistemeve kompjuterike është 20 kandidatë.
   - Zhvillues i web-it dhe i aplikacioneve mobile është 20 kandidatë.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit, i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të

cilat rekomandime, janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të kualifikimit/modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucion ofrues dhe/ose Vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

3. Vendimi i dërgohet:

Cacttus Education Sh.P.K,

Arkivit të AKK

REPUBLIKA E KOSOVËS * AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE * NATIONAL QUALIFICATIONS AUTHORITY * NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE * REPUBLIC OF KOSOVA

Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema